

VENDIM
Nr.1325, datë 1.10.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.277, DATË 18.6.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBËRIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr.277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë. Modeli i librezës së verbërisë përcaktohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha